**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosova**
**Komuna Drenasit**
**Municipality Drenas**
**Kuvendi i Komunës**
**Nr. 02-060/01-585 dt. 11/02/2026**

Në bazë të nenit 52 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 42, neni 44 pika 44.4 dhe pika 44.5 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 12 pika 12.2 dhe nenit 21 pika 21.2 të Rregullores së punës të Kuvendit. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës të Drenasit Burim Bujupi, me dt. **18.02.2026** (e mërkurë) duke filluar në ora 10:00, në sallën e mbledhjeve të Komunës.

**THËRRET**
**Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa**

Mbledhja do të këtë:

**Rend dite:**

1. Plani i punës së KKSB-së për vitin 2026.
2. Propozim vendim për miratimin e Planit Lokal të veprimit në mjedis 2025-2029.
3. Propozim vendim për miratimin e Planit Lokal për strategji të cilësisë së ajrit, Komuna e Drenasit 2025-2029.
4. Miratimi i raportit përfundimtar të komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.
5. Propozim vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit.
6. Propozim vendim për miratimin paraprak të vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Gllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik-juridik (për 99 vite)
7. Të ndryshme

Drenas, 11.02.2026

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Burim Bujupi

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY

| PRANUAR | 06/02/2026 | | |
|---|---|---|---|
| Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera |
| 01 | 030/01 | 5316 | |


**REPUBLIKA E KOSOVËS**

**KOMUNA DRENAS**

**Zyra e Kryetarit**

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi funksionon duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi. Puna e KKSB-së bazohet në dispozitat që rregullojnë çështjen e funksionimit si një organ këshillues për çështjet e sigurisë në bashkësi me përfaqësim të gjerë të gjitha komuniteteve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile.

Plani i punës është hartuar dhe aprovuar në mbledhjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, dhe i njëjti sipas udhëzimit duhet t'i prezantohet Kuvendit Komunal për miratim. Plani i mëposhtëm përfshin objektivat kryesore, aktivitetet, bartësit e aktiviteteve, dhe afatet kohore.

Qëllimi këtij plani është përmirësimi i sigurisë publike dhe ndërtimi i një komuniteti më të sigurtë si dhe rritja e bashkëpunimit mes institucioneve, qytetarëve dhe palëve të interesuara për sigurinë në komunitet.

## PLANI I PUNËS SË KKSB-SË PËR VITIN 2026

| Nr. rendor | Objektiva | Aktiviteti | Afati | Bartës i aktivitetit |
|---|---|---|---|---|
| 1. | **Rritja e vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin lokal** | ➢ Fushata Informuese<br>➢ Takime dhe diskutime me komunitetin<br>➢ Programet Edukative në Shkolla<br>➢ Angazhimi i autoriteteve dhe institucioneve lokale<br>➢ Aktivitete tjera ndërgjegjësuese | **Janar-Dhjetor 2026** | **KKSB/KLSP/ ZBGJ/OJQ/Drejtoritë komunale** |
| 2. | **Identifikimi i brengave lidhur me sigurinë publike** | ➢ Mbledhja e të dhënave nga burimet e ndryshme<br>➢ Organizimi i takimeve të rregullta<br>➢ Inspektimi dhe vlerësimi i gjendjes në terren, pra të infrastrukturës publike<br>➢ Bashkëpunimi me akterë tjerë të sigurisë si Policia dhe Institucionet e Zbatimit të Ligjit, Institucionet arsimore dhe Organizatat Rinore; Organizatat joqeveritar dhe fetare | **Janar-Dhjetor 2026** | **KSB/KLSP/ZBGJ/OJQ/ Drejtoritë komunale** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **3.** | **Rekomandimi i planeve të veprimit dhe adresimi i brengave të qytetarëve te autoritetet komunale** | ➢ Mbledhjet e KKSB-së<br><br>➢ Mbledhjet e KLSP-së<br><br>➢ Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve<br><br>➢ Mbledhjet e Kuvendit Komunal | **Janar-Dhjetor**<br><br>**2026** | **KSB/KLSP/ZBGJ/ OJQ/Drejtoritë komunale** |
| **4.** | **Ndërtimi i besimit në mes të policisë dhe qytetarëve nëpërmjet ndërtimit të partneritetit dhe iniciativave të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve të sigurisë në çdo bashkësi** | ➢ Takime të rregullta komunitare<br><br>➢ Përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje<br><br>➢ Iniciativa të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve<br><br>➢ Programe për forcimin e partneritetit<br><br>➢ Përdorimi i teknologjisë për të ndërtuar besimin<br><br>➢ Aktivitete të përbashkët me organizatat në Drenas | **Janar-Dhjetor**<br><br>**2026** | **KSB/KLSP/ZBGJ/OJQ /Drejtoritë komunale** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **5.** | **Përfaqësimi i pikëpamjeve dhe shqetësimeve të të gjithë qytetarëve, për çështjet e krimit dhe për çështjet tjera që lidhen me kualitetin e jetës** | ➢ Përfshirja e të gjithë grupeve të komunitetit<br>➢ Organizimi i forumeve dhe platformave të hapura<br>➢ Promovimi i përfaqësimit të barabartë<br>➢ Përfshirja e qytetarëve në zgjidhjen e problemeve | **Janar-Dhjetor 2026** | **KSB/KLSP/ZBGJ/ OJQ/Drejtoritë komunale** |

**Kryetar i Komunës**

**Ramiz Lladrovci**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
**Komuna e Drenasit**
Zyra e Kryetarit

**Nr** 01- 070/01- 5852 **dt.** 11/02/**2026**

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1, nën paragrafi h i Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit te Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 11, 12, 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës''), nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e ardhshme të aprovoi këtë:

**P r o p o z i m V e n d i m**
**Për Themelimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit.**

**Neni 1**

Më këtë Propozim Vendim i propozohet Kuvendit të Komunës themelimi i komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit në këtë përbërje:

1. ________________________-Kryesues;
2. ________________________-Anëtarë;
3. ________________________-Anëtarë;
4. ________________________-Anëtarë;
5. ________________________-Anëtarë;
6.

**Neni 2**

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtimin e rrugëve dhe pas shqyrtimit të këtyre kërkesave dhe ankesave komisioni harton raportin dhe i propozon kuvendit listën për aprovim.

**Neni 3**

Mandati i komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit është katër (4) vjeçar ashtu sikurse anëtaret e Kuvendit si dhe përfundon me përfundimin e mandatit të anëtarëve të kuvendit.

**Neni 4**

Me këtë vendim obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor që të bëjë regjistrimin për emërtim të rrugëve që merr vendim kuvendi për ndryshim apo emërtim të ndonjë rruge të re.

**Neni 5**

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.

Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Komuna e Drenasit në harmoni me legjislacionin në fuqi i cili e rregullon këtë fushë ka për obligim emërimin dhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike, si rrjedhojë e të cilit proces është edhe themelimi i komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit ku duke marrë parasysh këtë Kryetari i Komunës përmes këtij propozim vendimi i propozon Kuvendit të Komunës që duke marre parasysh legjislacionin ne fuqi dhe nevojës për themelimin e komisionit në fjalë që synon adresimin dhe zgjedhjen e problemeve të kësaj natyre në nivel lokal të votohet ky propozim vendim.

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
**Komuna Drenas/Gllogoc**
Zyra e Kryetarit

**Nr.01-** 400/01- 2636 **dt.** 16/01/ **.2026**

Në bazë të nenit 58, pika h të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit, 72 pika h e Statutit të Komunës së Gllogocit, në bazë të nenit 5,6,7,14 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, në bazë të nenit 5 paragrafi 1.3 të Rregullores QRK Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, dhe Vendimit të Listës së Veçantë të pronave të paluajshtme të Komunës së Drenasit, të cilat planifikohen të ipen në shfrytëzim afatgjatë gjatë vitit 2026 Nr.01-462/01-53377 dt.19.12.2025, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë ________.2026, të miratoj këtë:

**PROPOZIM VENDIM**

Për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Gllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik/juridik (për 99 vite).

Neni 1

Kuvendi i Komunës së Gllogocit të miratoj Propozim Vendimin për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Gllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik/juridik.

Neni 2

Prona e paluajtshme të propozuara për dhënie në shfrytëzim të cekur si në pikën 1 të këtij Propozim Vendimi është:

1. **Për shfrytëzim afatgjatë (për 99 vite)**

**Zona Kadastrale Gllobar**

-Ngastra kadastrale nr.438/4, me sip.2559 m²

-Ngastra kadastrale nr.438/5, me sip.1838 m²

- Pjesë e ngastrës kadastrale nr.12/0, me sip.2794 m²

- Pjesë e ngastrës kadastrale nr.67/0, me sip.15000 m²

- Ngastra kadastrale nr.13-0 me sip.8454 m²

- Pjesë e ngastrës kadastrale nr.81-0 me sip.4000 m²

- Ngastra kadastrale nr.41-0 me sip.16500 m²

**Zona Kadastrale Çikatovë e Re**

-Ngastra kadastrale nr.140-3, me sip.19244 $m^2$

-Ngastra kadastrale nr.126-2, me sip.2000 $m^2$

**Zona Kadastrale Gllogoc**

-Ngastra Kadastrale 878-5, me sip.4259 $m^2$

-Ngastra Kadastrale 758-1, me sip.1852 $m^2$

- Pjesë e ngastrës kadastrale 245-0, me sip.5000 $m^2$

**Zona Kadastrale Komoran**

-Ngastra kadastrale 4/124, me sip.6963 $m^2$

-Ngastra kadastrale 244/4, me sip.1863 $m^2$

-Ngastra kadastrale 244/5, me sip.1547 $m^2$

-Ngastra kadastrale 1980/0, me sip.2003 $m^2$

-Ngastar kadastrale 1981/0, me sip.3263 $m^2$

-Ngastra kadastrale 4-133 me sip.1059 $m^2$

**Zona Kadastrale Korroticë e Poshtme**

- Pjesë e ngastrës kadastrale 716-2, me sip.8003 $m^2$

-Ngastra Kadastrale 504 -0, me sip.2265 $m^2$

**Zona Kadastrale Korroticë e Epërme**

-Ngastra Kadastrale 34-0, me sip.8128 $m^2$

-Ngastra Kadastrale 208-1, me sip.13447 $m^2$

**Zona Kadastrale Arllat**

- Pjesë e ngastrës kadastrale 2652-4, me sip.3232 $m^2$

- Pjesë e ngastrës kadastrale 2529-3, me sip.10082 $m^2$

-Ngastra kadastrale 276-0, me sip.2303 $m^2$

- Pjesë e ngastrës kadastrale 2360 -0, me sip.23446 $m^2$

**Zona Kadastrale Polluzhë**

- Pjesë e ngastrës kadastrale 144 -0, me sip.21241 $m^2$

Të gjitha këto ngastra kadastrale janë pronë e Kuvendit të Komunës së Drenasit/Gllogocit.

Neni 3

Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim për përiudhë afatgjate, do të bëhet përmes procesit të Konkursit publik për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë dhe procedurave të parapara me Ligjin Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Gllogocit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së dhe pas publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

**ARSYETIM**

Duke u bazuar në nenet 5,6,7,14 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, në bazë të nenit 5 paragrafi 1.3 të Rregullores QRK Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, dhe Vendimit të Listës së Veçantë të pronave të paluajshtme të Komunës së Drenasit, të cilat planifikohen të ipen në shfrytëzim afatgjatë gjatë vitit 2026 Nr.01-462/01-53377 dt.19.12.2025, kërkesat e personave fizik dhe juridik të cilët shprehin interesin për marrje në shfrytëzim pronën e paluajtshme të Komunës, me qëllim për investime në fusha të ndryshme të ekonomisë, janë propozuar disa prona komunale për dhënien në shfrytëzim.

Komisioni Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës duke u bazuar në faktin së me dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës do të krijohen kushte për zhvillim të bizneseve, krijimin e mundësisë për investime nga investitorët vendor dhe të huaj me ç'rast do të krijohën vende të reja të punës, dhe do të ndikohet në rritjen e zhvillimit ekonomik në Komunë, dakordohet dhe i propozon Kuvendit të miraton këtë Propozim Vendim.Me dhënien e pronës komunale në shfrytëzim sipas dispozitave ligjore në fuqi, Komuna do të inkason edhe të hyra komunale të cilat konsiderohen para publike dhe i nënshtrohen dispozitave ligjore për menaxhimin e financave publike.

Bashkangjitur me këtë propozim gjeni: vendimin për shpalljen e Listës së Përgjithshme të Pronave të Komunës së Drenasit, si dhe Listen e Veçantë të Pronave të Paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënien në shrytëzim afatgjatë në vitin 2026, dhe paraqitjen tabelare të listës së veçant të pronave të paluajtshme të Komunës së Drenasit, të cilat planifikohen të ipen në shfrytëzim afatgjatë gjatë vitit 2026.

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
**Komuna e Drenasit/Gllogocit**
Zyra e Kryetarit

**Nr.01- 462/01-53377 dt. 19/12/2025**

Në bazë të nenit 58, paragrafi 1, pika h të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 72, pika h e Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 13 te Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 6 të Rregullores Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Zyre e Kryetarit nxjerrë këtë:

# VENDIM

Për publikimin e Listës së Përgjithshme të pronave të Komunës së Drenasit, si dhe Listës së Veçantë të Pronave të Paluajtshme të Komunës së Drenasit që planifikohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2026.

**Neni 1**

Me këtë vendim publikohet Lista e Përgjithshme e Pronave të Komunës së Drenasit e paraqitur në formë tabelare.

**Neni 2**

Pjesë e këtij vendimi është dhe Lista e Veçantë e Pronave të Paluajtshme të Komunës së Drenasit që planifikohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2026, e cila përfshin të dhënat kadastrale të pronave, lokacionin dhe destinimin e tyre me PZHK dhe Hartë Zonale.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

**Neni 5**

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

Vendimi i'u dërgohet:

*-Zyrës së Kryetarit*
*-Drejtorive Përkatëse*
*-Arkivit*

**Kryetari i Komunës**

**Ramiz Lladrovci**

## Arsyetim

Komuna e Drenasit duke u bazuar në faktin se me dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës do të krijohen kushte për zhvillimin e bizneseve, krijimin e mundësisë për investime nga investitorët vendor dhe të huaj me ç'rast do të krijohen vende të reja të punës, dhe do të ndikohet në rritjen e zhvillimit ekonomik në komunë.

Me dhënien e pronës komunale në shfrytëzim sipas dispozitave ligjore në fuqi, Komuna do të inkason edhe të hyra komunale të cilat konsiderohen para publike dhe i nënshtrohen dispozitave ligjore për menaxhimin e financave publike.

Po ashtu Kuvendi i Komunës së Gllogocit me datë 30.07.2020, ka miratuar Vendimin për Miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2020-2028, me të cilin është planifikuar zhvillimi ekonomik i Komunës së Gllogocit, ku pjesë e këtij plani janë edhe pronat të cilat janë pjesë e Listës së Veçantë që planifikohen të ipen në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2024.

Komuna e Gllogocit gjithashtu me datë 28.07.2022 ka miratuar edhe Hartat Zonale të Komunës së Gllogocit për vitin 2022-2030.

Baza juridike për t'i publikuar këtë listë është, neni 13 i Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, dhe neni 6 i Rregullores Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

**Bashkangjitur me këtë vendim i gjeni:**

*-Listën e përgjithshme të pronave të Komunës së Gllogocit;*
*-Listen e Veçantë të Pronave që Planifikohen për t'u dhënë në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2026;*
*-Skicat e parcelave të cilat janë pjesë e listës së veçantë.*

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova - Republic of Kosovo
**Komuna Drenas/Gllogoc**

**Nr.01-** 462101 - 53377 **,dt.** 19 / 12 **/2025**

**Lista e veçantë e pronave të paluajtshme të Komunës së Drenasit, që planifikohen për dhënie në shfrytëzim aftagjatë gjatë vitit 2026**

| Nr. | Ngastra Kadastrale | Sipërfaqja ($m^2$) | Zona Kadastrale | DESTINIMI (PZHK-Harta Zonale) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | *4 -124* | *6963* | Komoran | Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore   |
| 2 | 244/4 | 1893 | Komoran | Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore   |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| [illegible] | 244/5 | 1547 | Komoran | Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore   |
| 4 | 1980/0 | 2003 | Komoran | Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore   |
| 5 | 208-1 | 13447 | Korroticë e Epërme | Zonë bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)  |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 6 | 881-0 | 99648 | Çikatovë e Vjetër | Zonë bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)   |
| 7 | 438/4 | 2559 | Gllobar | Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore  |
| 8 | 438/5 | 1838 | Gllobar | Shërbim Tregtar Komercial, Ndërtimore  |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ) | 12-0 | 2794 | Gllobar | Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)<br> |
| 0 | 13-0 | 8454 | Gllobar | Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)<br> |
| 1 | Pjesë e parcelës 67-0 | 15000 | Gllobar | Zonë Ndërtimore (Banim i ulët rural)<br> |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| .2 | Pjesë e parcelës 81-0 | 4000 | Gllobar | Zonë Ndërtimore (Banim i ulët rural)  |
| .3 | Pjesë e parcelës 41-0 | 16500 | Gllobar | Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK) dhe Zonë Ndërtimore (Banim i ulët rural)   |
| .4 | Pjesë e parcelës 1963-0 | 103309 | Tërstenik | Zonë Bujqësore (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)   |
| | | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 5 | ***34/0*** | ***8128*** | Korroticë e Epërme | Zonë Industriale (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)<br> |
| 6 | 878-5 | 4259 | Gllogoc | Banim i lartë (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)<br> |
| 7 | 758-1 | 1852 | Gllogoc | Banim i lartë (shfrytëzime tjera të lejuara në përshtatshmëri me HZK)<br> |